

Nr.2183/3..... Prot
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më 12 05 . 2026

TERMAT E REFERENCËS
(SIGURIMI I ASETVE TË KESH SH.A.)

1. Vështrim i Përgjithshëm

KESH sh.a. është një shoqëri tregtare, me kapital të zotëruar në 100% nga Shteti Shqiptar, që ushtron veprimtari në prodhimin dhe tregtimin e energjisë elektrike, në Shqipëri. Shoqëria shfrytëzon për qëllime të ushtrimit të aktivitetit njësi prodhimi energjie HEC-e të ndodhura përgjatë lumit Drin në formë kaskade, si dhe asete të tjera të luajtshme dhe të paluajtshme, ndihmëse për aktivitetin kryesor.

Asetet gjeneruese të KESH sh.a., si dhe tërësia e aseteve të tjera që lidhen me këto asete gjeneruese, përbëjnë kapacitetin më të madh gjenerues në vend të energjisë elektrike dhe si rrjedhojë kanë rëndësi të veçantë jo vetëm për shoqërinë, por edhe me gjerë, me efekte në të gjithë sektorët ekonomik në vend. Për këtë arsye, këto asete janë nën një regjim të posaçëm ligjor. Përpos faktit që janë nën pronësinë e shtetit Shqiptar, mbi këto asete, KESH sh.a. gëzon përgjegjësi administrimi, referuar akteve nënligjore në fuqi.

Rreth 60% e energjisë në vend prodhohet prej këtyre aseteve gjeneruese dhe qarkullohet nga shoqëria KESH sh.a. nëpërmjet marrëdhënieve tregtare.

Çdo subjekt i cili mban të drejta dhe detyrime mbi asete të caktuara, ballafaqohet me mundësitë e dëmtimit të tyre nga ngjarje të ndryshme, për menaxhimin e të cilave mbajtësit e të drejtave përdorin mekanizma të ndryshme duke filluar nga administrimi i asetit/eve, menaxhimi i qarkullimit të tij, si ruajtja e tij fizike e deri në përdorimin e mekanizmave të sigurimit të aseteve me palë të treta.

Rregullimet ligjore të aplikueshme nga ana shoqërisë KESH sh.a. për menaxhimin e aseteve në përdorim, si dhe në tërësi menaxhimit financiar, janë ato të parashikuara në Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore në bazë e për zbatim, Urdhri Nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar.

Në bazë të këtyre parashikimeve dhe të proceseve që synojnë krijimin e sigurive në menaxhimin e ngjarjeve që mund të sjellin efekte negative mbi asetet, shoqëria KESH sh.a. në vazhdimësi ka realizuar sigurimin e aseteve të shoqërisë për grupet e aseteve me rëndësi të veçantë, si: ndërtesa, makineri&pajisje dhe pajisje informatike, për ngjarje të tilla, si: zjarri, tërmeti, rënie e objekteve fluturuese dhe përmblytje, përmbledhur si rreziqe të tjera.

Bazuar në sa më sipër dhe në politikat e shoqërisë për menaxhimin e ngjarjeve që mund të sjellin dëmtime mbi asetet, shoqëria kërkon të realizojë një shërbim nëpërmjet të cilit mundësojë për KESH mbulimin e risqeve që mund të vinë në asetet e shoqërisë nga ngjarje që mund të sjellin dëmtimin e tyre.

2. Metodologjia e përcaktimit të shërbimit të kërkuar dhe termave

Veprimtari siguruese në Republikën e Shqipërisë rregullohet nëpërmjet Ligjit Nr. 52/2014, datë 22.05.2014, “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, akteve nënligjore, rregullatorë për tregun e sigurimeve të dala në zbatim të tyre, si dhe që mbikëqyren nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

Shoqëria KESH sh.a. ka realizuar në vazhdimësi duke filluar nga viti 2015, sigurimin e aseteve të shoqërisë për ngjarje të caktuara si Zjarri dhe ngjarje të tjera, Tërmeti, Përmbytjet dhe dëmtimi nga përplasje e objekteve fluturuese.

Në Shqipëri ekziston një treg sigurimesh në të cilin ushtrojnë veprimtari disa shoqëri të licencuara për veprimtari në sigurimet jo jetë, përfshirë sigurimin nga zjarri, tërmeti dhe ngjarje të tjera, përmbytje dhe goditje nga objekte fluturuese.

Pjesë e proceseve të menaxhimit në shoqëri në lidhje me aktivitetin financiar, rregullohen në bazë të parashikimeve të Ligjit Nr. 10296, 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, dhe Urdhëri Nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar akte të cilët parashikojnë edhe trajtimin e risqeve të ndryshme që mund të vinë për shoqërinë përgjatë aktivitetit nëpërmjet sigurimit.

Në rastin e shoqërisë KESH sh.a., për shkak të rëndësisë dhe impaktit të madh financiar dhe jo vetëm të ngjarjeve të ndryshme me pasojë dëmtimin e aseteve të shoqërisë, lind nevoja e sigurimit të aseteve të KESH sh.a. nga ngjarje të pavarura nga shoqëria, ngjarje për të cilat shoqëritë e sigurimit në tregun shqiptar të sigurimit ofrojnë shërbim sigurimi.

Për përcaktimin e termave të shërbimit të kërkuar përdoren në tërësi parashikimet e veprimtarive si referuar më sipër dhe akteve rregulluese të mësipërme, më konkretisht dhe pa kufizim:

- Kontratat e mëparshme të sigurimit të aseteve të KESH sh.a. për periudhat 2015-2025;
- Kushtet e përgjithshme të aplikuara nga shoqëri sigurimi të licensuara për ushtrim aktivitetit në Republikën e Shqipërisë;
- Analizë e shoqërisë në zbatim të parashikimeve të Ligjit 10296 dhe akteve nënligjore në bazë e për zbatim të tij.
- Parime të përgjithshme lidhur me efektivitetin dhe efencën në shpenzimet publike.

3. Objekti i shërbimit:

- Kryerja e sigurimit të aseteve të shoqërisë KESH sh.a., të ndara në zërin Ndërtesa, Makineri&Pajisje dhe Pajisje Informatike për një periudhë një vjeçare, nga ngjarje si: zjarri, tërmeti, rënie e objekteve nga lartësia (objekte fluturuese) dhe përmbytje, përmbledhur si rreziqe të tjera.
- Rikuperimi në raste ngjarjeje sigurimi, të vlerës së siguruar të aseteve (shuma e siguruar).

Siguruesi do të sigurojë për shoqërinë KESH sh.a. pagimin e shumës së siguruar në rast të vërtetimit të ngjarjes së sigurimit.

Sigurimi i aseteve të KESH sh.a. për një periudhë 1 (një) vjeçare, gjatë së cilës siguruesi do dëmshpërblejë të siguruarin për humbjen, dëmtimin ose shkatërrimin e pasurisë së siguruar në mënyrë të papritur, të paparashikuar dhe aksidentale për ngjarjet të mbuluara nga polica e sigurimit.

Përcaktime të rreziqeve bëhet në përputhje me policat e sigurimit miratuara nga AMF për sigurimin për dëme nga zjarri dhe rreziqe të tjera në mënyrë përmbledhëse:

- Zjarr
- Rrufe
- Eksplozion
- Përplasje/rënie avioni dhe/ose pjesëve dhe/ose ngarkesave të tij
- Tërmeti.
- Përmbytje

Terma të kërkuar të shërbimit:

Shoqëria KESH sh.a. do të sigurojë asetet e saj për ngjarje si specifikuar më sipër.

Për qëllime të kontraktimit të shërbimit, kërkuksi i shërbimit ka marre në konsideratë marrëdhëniet e mëparshme kontraktore me të njëjtin objekt si dhe kushte të përgjithshme për kontratat e sigurimit nga zjarri dhe ngjarjet e tjera, si dhe tërmeti e përmbytja, të ofruara nga shoqëri që ofrojnë këtë shërbim, këto të publikuara në faqet zyrtare të këtyre shoqërive.

Shoqëria KESH sh.a. përcakton se oferta për primin e sigurimit, do të jepet për shërbim sigurimi me kushtet e veçanta, si vijon:

- **Asetet e siguruara**, janë asete të luajtshme dhe të paluajtshme të KESH sh.a. të paraqitura në listën analitike të aseteve, bashkëlidhur këtyre termave.
- Kërkuksi i shërbimit klasifikon asetet e siguruara në ndërtesa, makineri e pajisje, dhe pajisje informatike sipas listës bashkëlidhur.
- **Shumat e siguruara të aseteve**, janë vlerat e aseteve të individualizuar të kërkuksit të shërbimit KESH sh.a., të datës 31.12.2025, për secilën prej njësive të HEC Fierzë, HEC

Koman dhe HEC Vau i Dejës, Zyrat Qendrore të KESH dhe magazinat e KESH në Durrës, të cilat do të përbëjnë vlerën e aseteve që kërkohet të sigurohen, paraqiten në tabelën bashkëlidhur.

- **Shuma e siguruar** do të jetë vlera totale e **shumave të siguruara të aseteve**.
- **Ngjarje e sigurimit** është ngjarja për të cilat kërkuesi është siguruar, që sjellin humbjen, dëmtimin ose shkatërrimin e pasurisë së siguruar në mënyrë të papritur, të paparashikuar dhe aksidentale, dhe me vërtetimin e të cilave i siguruari ka të drejtën që të kërkojë dëmshpërblimin nga siguruesi.
- **Vlera e siguruar sipas kontratës së kërkuar** do të jetë sa shuma e siguruar dhe/ose shumë e siguruar e aseteve.
- Siguruesi pranon dhënien e ofertës për primin e sigurimit dhe sigurimin e listës së aseteve të siguruara për shumën e siguruar duke konsideruar se me realizimin e pagesës së primit, kërkuesi i shërbimit të sigurimit ka përmbushur të gjithë detyrimet që i vinë këtij të fundit nga marrëdhënie e sigurimit.
- **Periudha e sigurimit** do të jetë për një vit dhe do të fillojë pas pagesës së primit të sigurimit, në orën 00:00 të datës së përcaktuar në policën e sigurimit.
- Në policat e sigurimit të pasurisë nga zjarri dhe rreziqet shtesë, si rregull do të aplikohet pjesë e zbritshëm dhe franshizë.
- Për çdo rast dëmi të trajtueshem, Siguruesi do të mund zbresë nga dëmshpërblimi i llogaritur pjesën e zbritshme të përcaktuar, në policën e Sigurimit, si përqindje mbi çdo një dëm ose seri dëmsh, të shkaktuara nga një ngjarje e vetme sigurimi.
- Masat e pjesës së zbritshme dhe franshizës që do të përcaktohen në Policën e Sigurimit janë 10 % në ngjarje zjarri dhe ngjarje të tjera, minimumi 0.5% të shumës së siguruar. Tërmeti dhe përmytje 3% e shumës së siguruar.

Terma të kontratës së kërkuar të cilat nuk përfshihen në këto terma reference do të jenë ato terma që parashikohen në kushtet e përgjithshme të kontratës së sigurimit nga zjarri të aplikuar nga shoqëritë e sigurimit që ushtrojnë aktivitet në Shqipëri.

Në çdo rast parashikimet në këto terma reference do të bëhen pjesë e kushteve të veçanta të kontraktuara mes palëve dhe do të prevalojnë mbi kushtet e përgjithshme të sigurimit nga zjarri, ngjarjet e tjera, tërmeti dhe përmytja.

4. Listë e aseteve dhe shumat e siguruara

Bazuar në vlerën e aseteve të shoqërisë KESH sh.a. të datës 31.12.2025, për njësitë HEC Vau i Dejës, HEC Koman, HEC Fierzë, KESH Qendër (Aparat) dhe Magazina SL Durrës, vlerë e aseteve që kërkohet të sigurohet paraqitet e përmbledhur në tabelën si më poshtë vijon:

TAB.1

Vendosja	Pershkrimi asetit	Vlera bruto 31.12.2025 (Lekë)	Amortizimi i akumuluar 31.12.2025 (Lekë)	Vlera Neto 31.12.2025 (Lekë)
Fierze	Ndertesa	15,065,139,601.34	1,222,472,866.93	13,842,666,734.41
Komun	Ndertesa	16,255,376,467.79	573,699,097.23	15,681,677,370.58
Vau Dejes	Ndertesa	8,873,747,920.82	1,115,053,441.04	7,758,694,479.80
Aparati	Ndertesa	447,910,302.29	20,461,883.97	427,448,418.32
SI	Ndertesa	74,119,129.58	5,954,988.89	68,164,140.69
Totali Ndertesa		40,716,293,321.82	2,937,642,278.05	37,778,651,043.80
Fierze	Makineri dhe Pajisje	3,437,524,773.27	1,054,398,453.14	2,383,126,320.14
Komun	Makineri dhe Pajisje	9,877,845,337.61	2,990,230,489.19	6,887,614,848.43
Vau Dejes	Makineri dhe Pajisje	8,485,965,003.65	2,059,648,758.10	6,426,316,245.60
Totali Makineri & Pajisje		21,801,335,114.54	6,104,277,700.43	15,697,057,413.86
Vau Dejes	Pajisje Informatike	54,674,379.62	25,370,319.28	29,304,060.33
Aparati	Pajisje Informatike	439,915,587.79	225,236,778.46	214,678,809.33
Totali Pajisje informatike		494,589,967.41	250,607,097.74	243,982,869.67
Totali		63,012,218,403.77	9,292,527,076.22	53,719,691,327.34

- Kërkuesi i sigurimit ruan të drejtën që përgjatë kontratës së sigurimit të rishohë listën dhe vlerën e aseteve të siguruar në tërësi si dhe rrjedhimisht shumat e siguruar të aseteve me efekt jo më të madh se 5% të shumës totale të kërkuar për tu siguruar dhe për të cilën është lëshuar policë e sigurimit, referuar regjistrin të aseteve të rivlerësuar.
- Në rast se shumë e siguruar e rishikuar rezulton të jetë më e lartë atëherë i Siguruarit mund të kërkojë rritjen e shumës së siguruar, dhe merr përsipër pagimin e shtesës së primit të sigurimit i cili do të rritet përkatësisht, në raport me ofertën e dhënë.
- Në rast se shumë e siguruar e rishikuar rezulton të jetë më e ulët atëherë i Siguruarit do të kërkojnë zvogëlimin e shumës së siguruar, dhe siguruesi do të marrë përsipër kthimin e primit të sigurimit do të pakësohet përkatësisht, në raport me ofertën e dhënë.